

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 607 Prot.

Tiranë, më 14.09 2015

VENDIM Nr. 90, datë 1.09.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, të datës 1.09.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor të ri "Ekspeditë përnjohëse nënujore në liqenin e Ohrit"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Adrian Anastasi,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor të ri "Ekspeditë përnjohëse nënujore në liqenin e Ohrit"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Adrian Anastasi, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme për vitin 2015:
 - Survey në zonat "Lin 3" dhe "Hudenisht1" të cilat përfaqësojnë vendbanime prehistorike me palafite dhe i përkasin periudhës eneolite-fillimi i bronzit.
 - Dokumentimi i qendrave arkeologjike nënujore të fushës së prehistorisë me qëllim vënien në mbrojtje të tyre.
- II. Harta me propozimin për shpalljen në mbrojtje paraprake të zonave, të cilat përfaqësojnë vendbanime prehistorike me palafite, të depozitohet pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës.
- III. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda muajit shtator të vitit 2015.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO